



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:024091

Datë: 19.04.2024

Numri i dokumentit: 05597205

**C-IV.-14-4194**

*Ankuesi:*

**M M**, Kraljevo, Srbija.

*Të cilin e përfaqëson “Projekti për Ndhimë Juridike Falas, Graçanicë.*

*Kundër:*

*E paditura:*

**N.SH “Fabrika Ulja i Biljnih Masti”**, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Murat Hulaj, me dt.19 prill 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

**1.REFUZOHET** si e pa bazuar ankesa dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.GJI002-0021 i dt.25 prill 2014.

**2.Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me dt.21 maj 2014, ankuesi ish punëtor i NSH “Fabrika Ulja i Biljnih Masti” ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej “Dhoma e Posaçme”) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) nr.GJI002-0021 i dt.25 prill 2014, me të cilin ka kërkuar paga të pa paguara në shumë prej 25,000€ për periudhë të pa specifikuar. Ankuesi në ankesë ka deklaruar se të njëjtën e paraqet për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, shkeljes së dispozitave procedurale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ka shtuar se ankesa e tij është refuzuar për shkak të parashkrimit por se i njëjti i është drejtuar edhe më parë organeve për të realizuar të drejtën e tij dhe nuk ka marr përgjigje. Ankesës i ka bashkangjitur: kopjen e vendimit të kundërshtuar, kopjen e librezës së punës, kopjen e letërnjoftimit, kopja e kontratës së punës nr.676 dt.13.04.1993, formular i kërkesës për likuidim.

Gjykata me dt.10 tetor 2023, ka lëshuar një urdhër për ankuesin me anë të së cilës ka kërkuar që të bëjë dorëzimin e dokumenteve shtesë në mbështetje të pretendimeve ankimore, duke ia specifikuar secilën veç e veç. Ankuesi e ka pranuar urdhrin dhe me dt.13 tetor 2023, por deri në kohën e përpilimit të këtij vendimi nuk i është përgjigjur të njëjtit.

Me dt.07 mars 2024 e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se AKP e kundërshton në tërësi kërkesën e ankuesit duke shtuar se objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit të AL. Parashtruesi nuk tregon se cilin nen e ka shkelur AL në marrjen e vendimit e rrjedhimisht vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë ligjore dhe se ankesa është e parashkruar bazuar në nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar. Ka kërkuar që kërkesëpadia e ankuesit të refuzohet si e pa bazuar.

### **Arsyetimi ligjor**

Ankesa e ankueses refuzohet si e pabazuar, dhe vërtetohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësia apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuara), ndërsa par.3 parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmojë se i takon e drejta për të kërkuar pronësi të aksioneve. Ankuesi së bashku me ankesë ka dorëzuar: kopjen e vendimit të kundërshtuar, kopjen e librezës së punës, kopjen e letërnjoftimit, kopja e kontratës së punës nr.676 dt.13.04.1993, formular i kërkesës për likuidim.

Nga kjo gjykata vjen në përfundim që parashtruesi i ankesës nuk i ka përmbushur kriteret themelore të ankesës. Ankuesi do të mund të dorëzonte prova relevante në mbështetje të pretendimeve të tij ankimore, siç janë dokumentet me anë të së cilave do të dëshmonte se i takon e drejta e pretenduar. Gjykata gjen se, në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura në provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Ankuesi ka dorëzuar përmes ankesës, por të njëjtat nuk e vërtetojnë faktin që NSH ti ketë mbetur borxh paga. I njëjti do të mund të dorëzonte njoftimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës, listën e pagave të cilat pretendon se NSH-ja i ka mbetur borxh, si dhe prova tjera shtesë me të cilat do të i mbështeste pretendimet e tij ankimore, por ankuesi nuk ka dorëzuar asnjë provë relevante. Libreza e punës dëshmon se ankuesi ka ofruar shërbime për NSH-në, por nuk e dëshmon të drejtën e pretenduar me ankesë. Andaj, gjykata nuk mund të marr për bazë librezën e punës dhe provat tjera të dorëzuara nga i njëjti dhe ti pranoj si prova relevante asnjë apo provë përmes të cilës nuk mund të provohet e drejta e pretenduar.

Sa i përket parashkrimin të kërkesës të cilën e paditura është thirrur, gjykata e vlerësoi pa e marr si pretendim kryesor, për faktin se çështja e parashkrimin është institut i veçantë me afate të përcaktuara me ligj. Por, në këtë rast gjykata u mbështet në provat e prezantuara nga ankuesi, të cilat ishin të mjaftueshme për t'ia refuzuar kërkesën përtej afateve ligjore.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par..4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale. Ankuesi përfaqësohet nga Projekti për Ndihmë Juridike Falas.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gjyqtari,  
**Murat Hulaj**